



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 431/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bajram Rexhepit kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Bajram Rexhepit kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga Bajram Rexhepi kandidat për deputet për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, me të cilën pretendohet se gjatë procesit të numërimit të votave është dëmtuar ngase votat e tij nuk janë numëruar në mënyrë të drejtë dhe sipas tij, këtë numërim jo korrekt e kanë bërë komisionerët në shumë vendvotime në gjithë Kosovën me theks të veçantë në Mitrovicë. Po ashtu ka theksuar se me rastin e rinumërimit të votave të 439 kutive të votimit në QNR, ka marrë rrethë 1500 vota shtesë të cilat fare nuk janë numëruar në vendvotimet përkatëse.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i që pas shqyrtimit të kësaj ankese të urdhëroi rinumërimin e të gjitha kutive të votimit sa i përket votave të fituara nga kandidatët.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit te ankesës dhe shqyrtimit te shkresave te lendes, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk e ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar ato pretendime, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Për me tepër, sipas ankuesit KQZ me rastin e rinumërimit të votave në kutit e vendvotimeve të lartpërmendura ka korrigjuar gabimin në numërim, dhe me atë rast ankuesit votat e gjetura në ato kuti i janë llogaritur në rezultatin final të zgjedhjeve, gjë që tani sipas PZAP-it, nuk do te thotë patjetër se edhe në të gjitha vendvotimet tjera në Kosovë fletëvotimet e ankuesit janë keq numëruar, sepse për këtë ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë dhe nuk ka propozuar asnjë dëshmitar me të cilat dëshmi me bazë do të vihej në dyshim numërimi i saktë i të gjitha fletëvotimeve në Kosovë përkitazi me ankuesin.

Prandaj PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën në fjalë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 431/2014 më datën 30.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*